



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 23 Shkurt 2023

Nr: 71

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSON PËRGJEGJËS TË BASHKISË KONISPOL,
I NGARKUAR NGA LIGJI PËR RAPORTIM PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 23 Shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Keida Kula person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për bashkinë Konispol

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Konispol, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 11.02.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike të kryer nga bashkia Konispol, e cila rezulton e paraportuar në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

“U përkujtua, sot në Markat 80-vjetori i krijimit të çetës patriotike “Çamëria”.

Data: 23 Shkurt 2023

Nr: 71

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Konispol, për raportimin e veprimtarive publike”

Link:<https://www.facebook.com/photo/?fbid=584290967045668&set=pcb.584294570378641>

Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 1 (një) media publike.

Bazuar në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht denoncimin, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 13.2.2023, bashkisë Konispol i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 14.2.2023, ora 1:27 PM, bashkia Konispol, ndër të tjera bën me dije se: *“Aktiviteti është zhvilluar në datën 2 Shkurt 2023, ora 10:00 në Fshatin Markat, me rastin e Krijimit të Çetës Partizane Çamëria. Organizator ka qenë Organizata e Veteranëve dhe pjesëmarrës kanë qenë veteranë të luftës nacionalçlirimtare, përfaqësues të familjeve të dëshmorëve dhe banorë të zones”.*

Neni 4, pika 4, i vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ka përcaktuar qartazi subjektet që kanë detyrim për raportim në ndërfaqe për zhvillimin e veprimtarisë ose të aktivitetit publik. Raportimi në ndërfaqe bëhet nga sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore dhe vendore (monokratike ose kolegjiale).

Në komunikim elektronik me personin e kontaktit për bashkinë Konispol zj. Keida Kula, kam kërkuar informacion në lidhje me **personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për bashkinë Konispol.**

Nga komunikimi elektronik i datës 23.2.2023, me përfaqësues në bashkinë Konispol, zj. Keida Kuka me dije se: “Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për bashkinë Konispol është zj. Keida Selmani.”

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se bashkia Konispol, referuar nenit 92, pika 3 të Kodit Zgjedhor, nuk ka pasur detyrimin për raportim të veprimtarisë publike së mësipërme, pasi nuk ka qenë institucioni organizator i veprimtarisë publike, por ka qenë në cilësinë e të ftuarit. Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, rezultoi se objekti rast denoncimi, nuk përbën shkelje sipas parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S :

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Keida Kula, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Konispol
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Konispol, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI